



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.2.2026, mori këtë

VENDIM

- I. **MIRATOHET** bartja e 45 (dyzet e pesë) normave - pozitive nga niveli arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, 18 (tetëmbëdhjetë) norma - pozita do të barten në nivelin parafillor dhe 27 (njëzet e shtatë) norma- pozita do të barten në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët.
- III. Bartja e normave - pozitive si në pikën I të këtij propozimi, bëhet për shkak të rritjes dhe tejkalimit të nevojave për staf në nivelin parafillor si rrjedhojë e ndërtimit të IP-ve "Xixëllonja" dhe aneksit të IP-së "Ardhmëria", si dhe planifikimit për hapjen e IP- së së re në lagjen "Dardania".
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Arsimit, si dhe drejtoritë dhe sektorët tjerë kompetentë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-022/01-31220/26, më 2.3.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Behmi Kupina



Të nderuar, përfaqësues të Kuvendit të Komunës,

Ju njoftojmë se Drejtoria e Arsimit kërkon mbështetjen tuaj për miratimin e pikës së rendit të ditës, që ka të bëjë me bartjen e pozitave të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët.

Për informimin tuaj të drejtë, Drejtoria e Arsimit e ka të përcaktuar numrin e normave të stafit arsimor për secilin nivel të arsimit parauniversitar. Aktualisht, bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike, konstatojmë se kemi tejkalim të normave të lejuara në nivelet parafillor dhe fillor.

Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2024, konkretisht paragrafit 2 të nenit 12, theksohet se: “Numri i të punësuarve dhe shuma përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe shtesa nëpër nënprograme, mund të përshtaten me vendim të ministrit, me arsyetim përkatës nga Organizata buxhetore (OB), duke përjashtuar kufizimet e përcaktuara. Në rastin e OB-ve të nivelit lokal, nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit komunal.”

Andaj, për të mundësuar bartjen e normave të stafit arsimor nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelet parafillor dhe fillor, kërkohet mbështetja dhe miratimi nga ana juaj.

Aktualisht, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi **53 norma të lira**, ndërsa në nivelet parafillor dhe fillor vlerësojmë se kemi nevojë për bartjen e rreth **45 normave**. Në bazë të analizës së normave për **nivelin parafillor, propozojmë 18 norma**, ndërsa për **nivelin fillor dhe të mesëm të ulët 27 norma**.

Rritja dhe tejkalimi i nevojave për staf në nivelin parafillor është si pasojë e rritjes së kapaciteteve për fëmijë dhe edukatore, si rezultat i ndërtimit të institucionit të ri parashkollor “Xixëllonja”, si dhe ndërtimit të aneksit të kopshtit “Ardhmëria”.

Ndërtimi i institucionit “Xixëllonja” ka mundësuar pranimin e 120 fëmijëve të rinj, gjë që ka ndikuar në rritjen e nevojës për staf edukativ. Po ashtu, ndërtimi i aneksit të kopshtit “Ardhmëria” ka rritur kapacitetin edhe për 50 fëmijë të tjerë. Për më tepër, për vitin edukativ 2025–2026 planifikohet hapja e çerdhes së re në lagjen “Dardania”, e cila gjithashtu do të kërkojë staf shtesë dhe norma të reja.

Drejtoria e Arsimit ka adresuar kërkesat për rritje të normave në Ministrinë e Arsimit, e cila në bazë të informatave i ka përfshirë ato në Grantin specifik për Arsim, por deri më tani nuk ka pasur reflektim në rritjen e normave tona.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe përkrahjen tuaj, ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin, në të mirë të proceseve arsimore.